

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR NXITJEN E PUNËSIMIT”

I. QËLLIMI PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka për qëllim rritjen e punësueshmërisë së forcave të punës nëpërmjet ofrimit të shërbimeve dhe programeve publike të punësimit dhe vetëpunësimit, si dhe formimit profesional. Ky projektligj përcakton objektivat dhe funksionet e sistemit publik të shërbimeve të punësimit, programeve aktive dhe pasive të tregut të punës, formimit profesional si dhe institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e tyre.

Disa aspekte të tregut të punës dhe të ofertës së aftësive kërkojnë ndryshime rrënjësore dhe në të njëjtën kohë sistemi duhet të vazhdojë të hartojë politika të cilat janë domethënëse për situatën aktuale dhe, si të tilla, këto politika duhet të jenë realiste, të qenësishme dhe të arritshme në kohë duke u bazuar në kapacitetin për të ndryshuar dhe burimet ekzistuese. Qëllimi kryesor i këtij projektligji është identifikimi dhe skicimi i politikave të duhura nxitëse të punësimit në vend dhe kualifikimit profesional të forcës së punës, me qëllim që të hapen vende pune cilësore dhe mundësi për aftësi gjatë gjithë ciklit të jetës. Projektligji ka në qendër të tij rritjen e mundësive për punë të denjë nëpërmjet politikave efikase të tregut të punës, nxitjen e përfshirjes dhe kohezionit social, si dhe fuqizimin e tregut të punës.

Projektligji u hartua me qëllim reflektimin e ndryshimeve dhe dinamikave të tregut të punës pas një periudhë 22-vjeçare që nga viti i miratimit të ligjit ekzistues (1995). Gjithashtu, projektligji u hartua dhe nën frymën e vizionit qeverisës, ku kualifikimi profesional dhe punësimi duhet të jenë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën. Gjithashtu, nevoja për rishikim të politikave aktuale për nxitjen e punësimit dhe sistemit të kualifikimeve, në kuadër të përfshirjes së arsimit dhe formimit profesional, ishte e domosdoshme. Kombet e Bashkuara #Envision2030 - Qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm (SDG), qëllimi 8: Promovimi i rritjes ekonomike të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësimit të plotë dhe produktiv dhe punës së denjë për të gjithë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Programi i Këshillit të Ministrave 2017 – 2021 e ka vënë fokusin te punësimi dhe zhvillimi cilësor i forcës së punës, në përputhje me vizionin dhe direktivat e Bashkimit Evropian, Strategjisë Evropiane të Punësimit 2020, si dhe kërkesave për integrimin evropian të Shqipërisë në BE. Në vitin 2010 vendet e BE-së miratuan politika dhe strategji të reja deri më 2020, në mënyrë që të merret parasysh “të jetuarit modern” në linjë me “punësim të kënaqshëm” për të gjithë, në përputhje me konventat dhe deklaratat ndërkombëtare. Shqipëria nuk mund të jetë e ndarë nga këto zhvillime.

Gjithashtu, si pjesë e planifikimit strategjik rajonal është dhe strategjia SEE 2020, plani i veprimit i së cilës është miratuar nga Këshilli i Ministrave. Parimet thelbësore të kësaj strategjie janë rritja e prosperitetit dhe krijimi i vendeve të punës me 5 shtylla, kryesore ku dimensionin e punësimit është pjesë e shtyllës 4 dhe fokusohet në politikën e punësimit, ekonominë sociale dhe mobilitetin e punës.

Gjithashtu, SKZHI-ja ka parashikuar drejtimet dhe objektivat kryesore në të cilat do të zhvillohet sistemi.

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 – 2020 e ngarkon sistemin me detyra dhe aktivitete në lidhje me qeverisjen e tregut të punës, programe aktive të tregut të punës, të arsimit dhe formimit profesional etj.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në zbatim të orientimeve të programit të Këshillit të Ministrave, ka hartuar këtë projektligj, i cili fokusohet në çështjet kritike të punësimit. Në këtë program është parashikuar krijimi i institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë (sot Shërbimi Kombëtar i Punësimit), si një njësi e cila do të mbledhë në një dhe do të rikonceptojë, sipas praktikave më të mira, modernizimin e zyrave të punës, sistemin e shërbimeve të punësimit, programet e nxitjes së punësimit dhe aftësive. Projektligji, gjithashtu, është një nga hapat kryesorë për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 – 2020. Vendimi për të hartuar një projektligj të ri erdhi si rrjedhojë e mbështetjes së frymës dhe qasjes së re që i bëhet sistemit nga programi i Këshillit të Ministrave duke synuar përfshirjen në të të modelit të ri të shërbimeve të punësimit, model i cili është prezantuar në Shqipëri nga projekti ILO-IPA 2010 Zhvillimi i Burimeve Njerëzore, reformimin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, duke e kthyer në një institucion sa më funksional në tregun e punës.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është në harmoni me Kushtetutën, dhe është iniciuar nga ministri i Financave dhe Ekonomisë.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk synon përafrim me *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Në këtë projektligj është shtuar objekti i projektligjit, i përcaktuar në nenin 1 (në ligjin ekzistues nuk ka qenë).

Është rikonceptuar qëllimi i ligjit (neni 2) duke përcaktuar se ligji ka për qëllim rritjen e punësueshmërisë së forcave të punës, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve dhe programeve publike të punësimit, të vetëpunësimit dhe të kualifikimit profesional.

Në nenin 3 janë rishikuar termat, ndryshimi i të cilave ka ardhur si rezultat i rekomandimeve të BE-së dhe evoluimit të termave dhe nga legjislacioni shqiptar. Më konkretisht:

- Janë shtuar personat fizikë si përfitues;
- Ka një përmirësim të terminologjisë së përdorur sipas standardeve ndërkombëtare ILO Cedefop;
- Janë shtuar grupet e veçanta (shtresa vulnerabël me vështirësi për t'u integruar në tregun e punës);
- Është shtuar termi “Fondi”, i cili është Fondi Social i Punësimit, i krijuar sipas këtij ligji.

Në nenin 4 është bërë një rikonceptim i përfituesve të programeve që parashikohen në këtë projektligj.

Ky projektligj bën rregullimin e bazës ligjore për modelin e ri të shërbimeve të punësimit, prezantuar nga projekti ILO/IPA 2010, ku përfshihen:

- a) informimi i punëkërkuesve dhe punëdhënësve (neni 8), i cili do të bëhet nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë për kërkesën dhe ofertën në tregun e punës;
- b) ndërmjetësimi për punësim (neni 9), si një mjet që synon gjetjen e një vendi të përshtatshëm pune një punëkërkuesi, formimi, aftësitë dhe cilësitë e të cilit përputhen me kërkesat e deklaruara nga punëdhënësi për këtë vend pune;
- c) këshillimi dhe orientimi për karrierë (neni 10), që ka për qëllim t'i ndihmojë punëkërkuesit në zgjedhjen dhe formimin e tyre në një

profesion të përshtatshëm me cilësitë individuale dhe të kërkuar në tregun e punës.

Në kreun III janë trajtuar programet aktive të tregut të punës, në nenet 6, 7, 8, 9, 10, 11 dhe 12.

Në nenin 6 janë përcaktuar programet aktive të tregut të punës dhe aktivitetet që përfshihen.

Në nenin 7 detajohen shërbimet e punësimit, të cilat sipas modelit të ri tashmë ofrohen me tri nivele për punëkërkuesit. Pika 6 e këtij neni ka lidhje me ofrimin e veprimtarisë së ndërmjetësimit për punësim dhe këshillim profesional nga subjektet private. Gjatë vitit 2018, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë u miratuan dy vendime të Këshillit të Ministrave: vendimi nr.101, datë 23.2.2018, “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të agjencive private të punësimit”, dhe nr.286, datë 21.5.2018, “Për disa rregulla të veçanta për punëmarrësit e përkohshëm të cilët punësohen nga agjencitë e punësimit të përkohshëm”, të cilat janë dy tipe të ndryshme të agjencive private dhe e ushtrojnë në mënyrë të ligjshme këtë veprimtari.

Neni 8 ka lidhje me informimin e punëkërkuesve dhe punëdhënësve, duke i parashikuar të gjitha informacionet që japin punonjësit e zyrave të punësimit.

Neni 9 ka parashikuar dhe trajtuar ndërmjetësimin për punësim dhe përputhjen me vendin e punës.

Në nenin 10 janë trajtuar shërbimet e këshillimit dhe të orientimit për karrierë, punësim e profesion, që ofrojnë zyrat e punësimit.

Programet e krijimit të vendeve të reja të punës (neni 11), ku është përfshirë një gamë më e gjerë programesh sesa ato të parashikuara në ligjin ekzistues.

Për të arritur në riformulimin e këtij neni, me mbështetjen e projektit ILO – IPA 2010 “Zhvillimi i Burimeve Njerëzore në Shqipëri”, u bë një studim i gjerë i impaktit të të gjitha programeve të nxitjes së punësimit, të zbatuara që nga viti 2008 – 2014. Qëllimi i një vlerësimi të tillë ishte të analizonte dhe të maste efektivitetin, rëndësinë dhe efikasitetin e hartimit dhe të zbatimit të programeve aktive të tregut të punës, të zbatuara në këtë periudhë. Qëllimi i këtij studimi ishte të bënte jo vetëm analizën e impaktit të këtyre programeve në tregun e punës por më e rëndësishmja ishin gjetjet dhe rekomandimet, të cilat u përdorën për të na orientuar në programimin e këtyre programeve në këtë projektligj. Rekomandimet nxorrën përfundime të ndryshme në lidhje me hartimin dhe zbatimin e këtyre programeve në të ardhmen, të cilat janë pasqyruar në këtë projektligj.

Programet e nxitjes së punësimit, sipas projektligjit përfshijnë angazhimin e

punëkërkuesve të papunë në programe të ndryshme punësimi, punësh publike, vetëpunësimi, praktikash profesionale apo trajnimi, për të cilat mbështeten, subvencionimi, në përqindje të caktuar, i kostove për:

- sigurimet e detyrueshme shëndetësore dhe shoqërore;
- pagat;
- formimin profesional;
- formimin nëpërmjet punës;
- vetëpunësimin;
- mbështetjen për bizneset e reja dhe inkubatorët e biznesit;
- pajisjen e vendit të punës dhe akomodimin e arsyeshëm;
- zbatimin e programeve për mbështetjen e kualifikimit profesional në formën e dyfishtë të arsimit dhe formimit profesional;
- programet e mbështetjes së të diplomuarve/certifikuarve në arsimin dhe formimin profesional;
- praktikat profesionale;
- programin e garancisë rinore;
- programet e riintegrit social;
- transportin për në vendin e punës;
- të tjera.

Programet e nxitjes së punësimit administrohen dhe zbatohen nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, në bashkëpunim me institucione të tjera publike përgjegjëse për zhvillimin ekonomik dhe kualifikimim, si dhe në bashkëpunim me sektorin privat dhe shoqërinë civile. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë mund të kontrakttojë subjekte të tjera publike, private apo shoqëri civile, për të bërë të mundur zbatimin me cilësi dhe në kohë të programeve të nxitjes së punësimit.

Në projektligj janë parashikuar dhe programet e fokusuara te të rinjtë. Kjo për arsye se papunësia e të rinjve 15 – 29 vjeç, sipas INSTAT-it, në fund të vitit 2014 ishte në nivelin 32.5% nga 17.9% që ishte papunësia zyrtare për të njëjtën periudhë. Kështu programet e reja të parashikuara janë:

- programet e garancisë rinore, që janë programe të cilat po përdoren nga vende të ndryshme të Evropës gjatë tri viteve të fundit. Këto programe parashikojnë angazhimin e të rinjve të regjistruar si punëkërkues të papunë, që brenda një periudhe disa mujore të angazhohen në një nga programet të cilat zbatohen nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, si programet e nxitjes së punësimit për punësim të menjëhershëm, praktikat profesionale, formim nëpërmjet punës, arsim apo formim profesional etj.
- programi “transport për në vendin e punës” i cili ka parashikuar rastet kur vendi i punës është larg vendbanimit të punëkërkuesit dhe për të mospenguar punësimin, ky program do të parashikojë mbështetje për transportin.

Programet e formimit profesional, si pjesë të programeve aktive të tregut të punës, janë parashikuar në nenin 12 dhe është parashikuar që ky program t'u shërbejë si punëkërkuesve edhe punëdhënësve dhe realizohet nëpërmjet proceseve mësimore dhe kurseve të mësimi teoriko-praktike. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë do të jetë institucioni që zbaton programet e formimit profesional dhe do të ofrojë:

- kurse pa pagesë për punëkërkuesit e papunë;
- kurse me pagesë për persona që e kërkojnë një gjë të tillë;
- mjedise dhe mjete logjistike kundrejt qirasë për subjekte që ushtrojnë formimin profesional.

Gjithashtu, po në nenin 12 janë parashikuar forma të tjera mbështetjeje, si për ofruesit publikë ashtu dhe për ata privatë, për t'u mbështetur financiarisht për kryerjen e kurseve për punëkërkuesit e papunë, për profesione të kërkuara në tregun e punës, sipas kërkesave të strukturave rajonale/vendore.

Në projektligj është shtuar dhe kreu “Programet pasive të tregut të punës”, ku është parashikuar dhe programi i të ardhurave nga papunësia (neni 13), program i cili është pjesë e paketës së programeve që zbatohen nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë. Programi i pagesës së papunësisë është rregulluar nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pasi është me bazë kontributesh të vetë përfituesve. Personat, të cilët plotësojnë kushtet për përfitimin e të ardhurave nga papunësia, rregjistrohen në strukturën rajonale/vendore, si punëkërkues të papunë dhe paraqiten periodikisht në këtë strukturë, si kërkues aktivë pune.

Nenet 11, 12, 21 dhe 22, të projektligjit, që kanë të përfshirë nxitjen e punësimit të personave me aftësi të kufizuara, kanë për qëllim të rregullojnë atë pjesë të ligjit ekzistues i cili nuk gjente zbatim pikërisht për këto nene. Përveç mbështetjes për programe nxitjeje punësimi, përshtatjeje të arsyeshme, janë rregulluar dhe çështjet e detyrimit për të punësuar persona me aftësi të kufizuara nga punëdhënësit (nenet 21 dhe 22, shpjegimi më poshtë).

Kreu V i projektligjit parashikon ngritjen e institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, për të cilin është ndryshimuar emërtimi nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit (siç është sot) në një agjenci pa ndryshuar statusin juridik të tij. Kjo bëhet në mbështetje të programit të qeverisë, ku është parashikuar ndërtimi i kësaj agjencie, e cila do të mbledhë në një dhe do të rikonceptojë, sipas praktikave më të mira, modernizimin e strukturave rajonale/vendore të punësimit, sistemin e sigurimeve të punësimit, programin e nxitjes së punësimit dhe trajnimet profesionale politika dhe programe këto të parashikuara në nenet 5-13 të projektligjit.

Neni 14 parashikon krijimin nga Këshilli i Ministrave të institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë.

Neni 15, në pikën 1 parashikon që Këshilli Konsultativ Tripalësh është organ këshillimor i institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, si dhe numrin dhe përbërjen e anëtarëve të këtij këshilli.

Në pikat 2 dhe 3, të këtij neni, përcaktohen mandati dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të këshillit. Gjithashtu, përcaktohet dhe hartimi i një rregulloreje për ushtrimin e veprimtarisë së këshillit, të miratuar nga ministri përgjegjës për çështjet e punësimit.

Pika 4, e nenit 15, parashikon kompetencat kryesore të Këshillit Konsultativ Tripalësh, që janë:

- Këshillon për projektbuxhetin për vitin në vazhdim;
- Këshillon për investimet e fondeve;
- Këshillon për kontrata dhe marrëveshje më të rëndësishme;
- Të tjera;

Neni 16 i projektligjit parashikon ngritjen e Këshillit Vendor Tripalësh, si organ konsultativ pranë strukturës rajonale/vendore si organ konsultativ, ku janë përcaktuar të drejtat, detyrat dhe përbërja e Këshillit Vendor Tripalësh.

Nenet 17 dhe 18, parashikojnë se si do të funksionojë sistemi i informacionit të tregut të punës. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë mbledh e përpunon informacion nëpërmjet sistemit të informacionit të institucioneve të varësisë ose nëpërmjet studimeve specifike apo anketimeve që kanë të bëjnë me dinamikat dhe tendencat e tregut të punës apo segmente të tij. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë përpunon, analizon dhe raporton në ministri e institucione të tjera publike e private që e kërkojnë një informacion të tillë.

Gjithashtu, është parashikuar që institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë kryen hulumtime periodike pranë ndërmarrjeve për mbledhjen e të dhënave mbi numrin e të punësuarve, kushtet e punës, procesin e rekrutimit, mungesën e aftësive apo nevojave për trajnim sipas metodologjive kombëtare/ndërkombëtare të testuara dhe/apo të miratuara.

Në nenin 18 është parashikuar se ministria përgjegjëse për çështjet e punës i siguron INSTAT-it statistikën e papunësisë së regjistruar, duke bërë përcaktimin e informacionit të mbledhur në koordinim me të, në mënyrë që të ketë një sistem të harmonizuar të sistemit të mbledhjes të të dhënave dhe analizave.

Kreu VII tregon se në këtë projektligj është rikonceptuar i gjithë procesi i marrëdhënies me punëdhënësit. Në nenin 19 janë përcaktuar të drejtat e punëdhënësve, duke e konsideruar atë si një proces bashkëpunimi dhe jo një proces detyrimesh të njëanshme nga ana e punëdhënësve, siç është në ligjin e ekzistues. E gjithë kjo pjesë është riparë dhe në zbatim të paketës “Të bësh

biznes”, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, me qëllim lehtësimin e procedurave për fillimin e një biznesi të ri. Kështu, në këto nene është parashikuar se çdo punëdhënës ka të drejtë të marrë informacion mbi tregun e punës, legjislacionin e punës, programet shtetërore të punësimit në zyrat e punësimit. Gjithashtu, punëdhënësi ka të drejtë të publikojë në këtë strukturë vendet e lira të punës për të përfituar nga shërbimet e ndërmjetësimit si dhe të aplikojë. Punëdhënësit kanë të drejtë të aplikojnë në strukturën përkatëse rajonale/vendore të punësimit për të përfituar nga programet aktive që zbaton institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë.

Në nenin 20 parashikohet detyrimi i punëdhënësve përfitues të fondeve publike në formën e investimeve të Këshillit të Ministrave apo dhe koncesioneve në punë publike, për të punësuar punëkërkues të papunë të regjistruar në strukturat rajonale/vendore të punësimit, sipas rregullave që do të vendosen nga Këshilli i Ministrave.

Gjithashtu, po në këtë nen është parashikuar detyrimi i punëdhënësve për të informuar strukturat përkatëse rajonale/vendore të punësimit, për falimentimin e mundshëm të tij, jo më vonë se një muaj nga data e pritshme e mbylljes së veprimtarisë. Kjo kërkohet për arsye që struktura rajonale/vendore e punësimit të jetë e përgatitur për fluksin e personave që dalin të papunë për një falimentim të tillë, pasi struktura rajonale/vendore e punësimit zbaton programin e pagesës së papunësisë.

Neni 21 i projektligjit i dedikohet personave me aftësi të kufizuara. Në pikën 1 është parashikuar se çdo punëdhënës që punëson më tepër se 49 punonjës është i detyruar të punësojë një person me aftësi të kufizuara, për çdo 50 punonjës të personelit të tij. Në pikën 2 parashikohet se punëdhënësi, i cili nuk punëson numrin e përcaktuar të personave me aftësi të kufizuara, sipas pikës 1, të këtij neni, derdh një kontribut për llogari të Fondit Social të Punësimit, në masën e gjysmë page minimale në shkallë vendi, për çdo muaj, për çdo person me aftësi të kufizuara, që ai duhet të kishte punësuar sipas këtij neni (aktualisht, paga minimale në shkallë vendi e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave është 26 000 lekë, pra kjo masë është 13 000 lekë). Procedura dhe mënyra e derdhjes së kontributit përcaktohet me udhëzim të ministrit përgjegjës për çështjet e punësimit. Një punëdhënës mund të punësojë një person me aftësi të kufizuara të thella në vend të pesë personave me aftësi të kufizuara të lehta. Të ardhurat e mbledhura në zbatim të pikës 2, të këtij neni dhe sipas procedurave të udhëzimit përkatës, do të përdoren për programe që synojnë punësimin, vetëpunësimin, rehabilitim për punë, aftësim dhe riaftësim profesional, orientim dhe këshillim për punësim, shërbime mbështetëse, si dhe përshtatjen e arsyeshme në vende pune të këtyre këtyre personave.

Vendosja e kuotave për punësimin e personave me aftësi të kufizuara është një praktikë e cila përdoret nga shumë vende të botës, si një mënyrë përfshirje të tyre në tregun e punës. Personat me aftësi të kufizuara e kanë shumë të vështirë

përfshirjen në tregun e punës, pra të punësohen, dhe kjo vjen si rezultat i hezitimit nga ana e punëdhënësve për shkak të aftësisë së tyre të kufizuar. Për këtë arsye, vendosja e kuotave është vënë në ligjin nr.7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar dhe është një e drejtë e fituar nga kjo kategori të cilën nuk mund t’i hiqet nga ky projektligj.

Ky nen nuk përfshin punëdhënësit, të cilët kanë kritere të ndryshme rekrutimi të stafit, të rregulluara këto me ligje të posaçme, të cilët prevalojnë mbi këtë projektligj.

Dispozitat në lidhje me personat me aftësi të kufizuara për detyrimet e sipërpërmendura kanë qenë totalisht të pazbatuara, për arsye të moskrijimit të Fondit Kombëtar të Punësimit ku do të derdreshin detyrimet e punëdhënësve, pra paga minimale në shkallë vendi për çdo person me aftësi të kufizuara që nuk kishin punësuar. Për këtë arsye, është propozuar me këtë projektligj që të gjitha të ardhurat e mbledhura nga derdhjet e punëdhënësve në buxhetin e shtetit të vihen në dispozicion në vitin pasardhës në një llogari të veçantë të buxhetit të institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, të cilat kjo e fundit do t’i përdorë për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit për personat me aftësi të kufizuara, në bashkëpunim me punëdhënësit.

Neni 22 parashikon krijimin e Fondit Social të Punësimit, në formën e një fondi financiar publik. Pika 2 parashikon burimet se nga krijohet ky fond dhe pikat 3, 4 e 5 përcaktojnë rregulla të funksionimit dhe përdorimit të fondit. Në pikën 6, të këtij neni, parashikohet se Fondi Social i Punësimit administrohet nga Bordi i Administrimit të Fondit, sipas legjislacionit në fuqi. Përbërja, kriteret dhe detyrat e Bordit të Administrimit të Fondit, si dhe mënyra e përdorimit të fondit, sipas pikave 4 e 5, të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Kreu VIII (neni 23) parashikon sanksionet për punëdhënësit, që nuk derdhin kontribute, sipas pikës 2, të nenit 21, të këtij ligji, dhe procedurat në zbatim të ligjit nr.9634, datë 30.10.2006, “Për inspektimin e punës”, të ndryshuar.

Në kreun IX janë parashikuar dispozita përfundimtare.

Neni 24 parashikon shfuqizimin e ligjit nr.7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar.

Neni 25, në pikën 1 parashikon funksionimin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, deri në momentin e krijimit të institucionit përgjegjës për punësimin dhe aftësitë.

Në pikën 2 parashikohet se aktet nënligjore, në zbatim të ligjit nr.7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, të ndryshuar, qëndrojnë në fuqi deri në daljen e akteve të reja, për aq sa ato nuk bien në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji.

Nenet 26 dhe 27 parashikojnë përkatësisht nxjerrjen e akteve nënligjore dhe hyrjen në fuqi të projektligjit.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Institucionet dhe organet që ngarkohen për zbatimin e këtij projektligji janë Ministria e Financave dhe Ekonomisë, institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë (sot Shërbimi Kombëtar i Punësimit) dhe Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Në hartimin e projektligjit kanë marrë pjesë përfaqësues të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, projekti ILO/ IPA 2010, projekti UNDP “Aftësi për punësim”, projekti GIZ, Agjencia Kombëtare për Arsimin dhe Formimin Profesional.

Projektligji është konsultuar me ekspertë të fushës gjatë muajit mars 2015. Gjithashtu, është konsultuar në komisionin e nxitjes së punësimit dhe formimit profesional të Këshillit Kombëtar të Punës dhe në mbledhjen e datës 20 prill 2015 u miratua nga Këshilli Kombëtar i Punës.

Projektligji është publikuar për konsultim publik në faqen zyrtare të internetit. Tabela e konsultimit publik është bashkëlidhur këtij relacioni.

Projektligji “Për nxitjen e punësimit” u përzgjedh nga Kryeministria për t’u miratuar sipas metodologjisë për raportin e vlerësimit të ndikimit, i cili i bashkëlidhet këtij relacioni.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Financimi do të bëhet nga buxheti i shtetit për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, sipas parashikimeve buxhetore afatmesme dhe afatgjata në PBA 2019-2021, në programin buxhetor 10550 “Tregu i punës” dhe programin buxhetor 09240 “Arsimi i mesëm profesional”.

KËSHILLI I MINISTRAVE